

KONTRATE DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot, ne daten **16.05.2025 (dymije e njezete e pese)**, ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate dhurimi kuotash si me poshte vijon:

DHURUES: Bernardo Coglianesi, atësia Giuseppe, shtetas Italian, lindur ne Itali më 03.09.1979 dhe banues me adrese Via Vazza, Oliveto Citra, Itali, identifikuar me Leternjoftim ID Nr. CA91743GS, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e ortakut të vetem prej 100% të shoqërisë tregtare LA FENICE GOLD shpk prej 100% qe ne kontrate referohet si "Dhuruesi"

dhe

PRANUES: Fulvio Cafararo atësia Silvano, amësia Sabrina, shtetas italian, lindur në San Giovanni Rotondo (FG) më 14.04.2004 dhe banues në Avellino, Via annunziata 28 ariano Irpino, Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID Nr. CA65132VI, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, qe ne kontrate referohet si "Pranuesi"

Dhuruesi dhe Pranuesi referuar te dy se bashku do te quhen "Palet".

Te pergjithshme

1. Dhuruesi eshte ortak i vetem i Shoqerise LA FENICE GOLD shpk, me NIPT M51411044I dhe me seli ne Rr. Myrtezim Kellici, PL.AL-FAM, Nr.23, Tirane, ketu e me poshte referuar si Shoqeria.
2. Ne kete Shoqeri pala dhuruese eshte pjesemarrese si ortak i vetem, ne masen 100%, me 1 kuote.
3. Dhuruesi dëshiron t'i dhuroje Pranuesit 50% të kutotave që zotëron në këtë shoqëri dhe Pranuesi dëshiron ti pranoje sipas parashikimeve të kësaj kontrate i cili pas kalimit të kuotave bëhet ortak ne masen 50% dhe te 1 kuote te shoqërisë "La Fenice Gold" shpk.
4. Ne perputhje me "Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave", sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, neni 761 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise "Dispozitat e Pergjithshme per dhurimin", hartohet kontrata e dhurimit se kuotave si me poshte vijon:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, dhuruesi i kalon nëpërmjet dhurimit një pjesë të tij qe është e barabarte me me 1 kuote dhe 50 % te kapitalit te shoqerise Pranuesit si dhe te drejten e pronesise mbi kuotat dhe gjithë te drejtat dhe detyrimet e tjera te lidhura me kete pjesemarrje.
- 1.2 Pranuesi nga ana tjetere merr nga dhuruesi kuotat e tij ne këtë shoqëri, duke u bërë kështu ortak në Shoqëri me 50% te kuotave.


FULVIO CAFARARO


BERNARDO COGLIANESI

1.3 Bazuar ne kapitalin e shoqerise, vlera e kuotave te dhuruara është Lek 50.000 (pesëdhjete mije leke).

1.4 Dhurimi nuk eshte i renduar me asnje kusht apo barre te cilen Dhuruesi eshte i detyruar te permbushe per kete dhurim, kundrejt Pranuesit. Cdo detyrim tjeter ndaj te treteve merret persiper prej Pranuesit, sipas kushteve te parashikuara ne kete kontrate.

Neni 2

Kalimi i kuotave

2.1. Duke marre parasysh qe Shoqëria është themeluar me 11.02.2025 dhe nuk ka kryer aktivitetet tregtar, transferimi do te behet pa kundëshperblim, ne forme dhurimi.

Kalimi i kuotave behet me dhurim, pa asnje pagese nga asnjera pale.

Neni 3

Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat

3.1 Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat nga Dhuruesi te Pranuesi si dhe te drejtat e detyrimet e ketij te fundit, i fillojne efektet juridike menjehere me nenshkrimin e kontrates.

3.2 Pas nenshkrimit kontrata do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Regjistrimi

Regjistrimi i kalimit te kuotave nga Dhuruesi te Pranuesi ne Qendren Kombetare te Regjistrimit do te kryhet menjehere pas nenshkrimit te kontrates prej Pranuesit.

Neni 5

Ligji i zbatueshem

Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, neni 761 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, si dhe dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

Neni 6


Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

PALET

DHURUESI

Bernardo Coglianesi



Bernardo Coglianesi

PRANUESI

Fulvio Cafararo



CAFARARO
FULVIO